



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:086316 C. nr. 936/2017
Datë: 28.03.2024
Numri i dokumentit: 05518565

GJYKATA THEMELORE PRIZREN, gjyqtari Atdhe Berisha, në çështjen juridiko-kontestimore të paditësit, J.K. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson avokati D.Sh. nga Prizreni, kundër të paditurit, P.N. nga Prizreni, tani me vendbanim në Serbi në adresë të panjohur, për kompensim dëmi, jashtë seance, me datë, 28.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Konstatohet e tërhequr padia në këtë çështje kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur përmes të autorizuarit të vetë, kundër të paditurit ka kërkuar nga gjykata të detyron të paditurin të kompenson paditësin për sipërfaqen prej 40 m².

Me parashtresën e datës 27.03.2024 i autorizuari i paditësit e njofton gjykatën që e tërheq padinë kundër të paditurit.

Pasi që pala paditëse ka njoftuar gjykatën se e tërheq padinë në këtë çështje kontestimore, gjykata në kuptim të nenit 261 të LPK-së, vendosi që të konstatohet se padia është tërhequr.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

C. nr. 936/2017 datë 28.03.2024

Gj y k a t ë s i
Atdhe Berisha

UDHËZIME PËR ANKESË: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.